VENDIM
Nr.851, datë 21.10.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË E LIBRAZHDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Librazhdit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Librazhdit.

3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 550 m^2 tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të cilëve shpronësohen, është 1 44 650 (njëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Librazhdit, planifikuar në buxhetin e saj.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Librazhdit.

8. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Librazhdit, për realizimin e këtij projekti.

9. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 550 m^2 tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Librazhdit, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Librazhdit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE

Nr.	Emër, mbiemër	**Sip.arë m^2**	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale
1	Seladin Buzhiqi	550	263	144 650	114/12	1063
	Totali	**550**		**144 650**		